REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 28/09/2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/263

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë:07.09.2026

Procesverbal
i mbledhjes së -III-(tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete

Koha: 07.09.2026 ora 09:10
Vendi :Salla e mediave

Të pranishëm:Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala,anëtarët e komisionit:Hafir Rexha, Nurije Islamaj, Naser Malisheva,Vjosa Shala.
Drejtori për Shërbime Publike z.Izet Hoti.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e hedhi në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Drejtorin e drejtorisë për Shërbime Publike z.Izet Hoti.
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komitetit për Komunitete .
Rezultati i votimit:5 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala konstatoi se shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komitetit për Komunitete.
Rezultati i votimit:5 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Takim me Drejtorin e drejtorisë për Shërbime Publike z.Izet Hoti.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala:Drejtoria për Shërbime Publike e ka fushëveprimtarin e saj në sfera të gjera me të cilën e prek gjdo qytetarë të komunës së Malishevës,dhe ne e kemi vlersuar si të nevojshme që me ftuar dretjorin në takim për me na informuar në pika të shkurta aktivitetet që janë zhvilluar si dhe gjendjen aktuale të cilën janë duke u përballuar qytetarët tanë me ujin e kështu me rradhë.Hapi debatin për këtë pikë.

Hafir Rexha(anëtar i komisionit):Përshëndetje për të gjithë!Ne sot në këtë takim e kemi prezent Drejtorin i cili ballafaqohet më së shumti me nevojat dhe kërkesat e qytetarët,neve na intereson një raport për mbeturinat dhe ujin raporti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike K.R.M "EKO Regjionin" dhe KRU " Hidroregjionin Jugor" sepse këto dy kompani janë që kanë lidhshmëri me këtë drejtori dhe i prekin interesat e qytetarëve.Sa janë komiteti i përgjegjshëm ndaj kompanive dhe sa janë në shërbim të qytetarëve?

Izet Hoti(Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike):Përshëndetje për të gjithë!Në sezonën e verës për shkak të fluksit të madh të mërgimtarëve,ne kemi problem me ujin,jemi të hendikepuar për shkak se nuk është duke e përballuar furnizimin e mjaftueshëm me ujë.Ministria e ka sjellur një projekt tek ne i cili është përafërisht shtatë milion dhe ai është duke u inplementuar në faza të ndryshme,gjithashtu parashihet që punimet e saj të realizohen brenda dy ose tri vite.Sa i përket raportit që ne kemi me KRU " Hidroregjionin Jugor" kemi kërkuar që ata me na sjellur raportin me shkrim,por nuk e kanë sjellur mirëpo në bazë të asaj që ne e kemi studiuar 85% e ujit të ujësjellsit në Malishevë humbet e cila është shumë shqetësuese për ne dhe qytetarët.Pjesë e projekti është ndërimi i rrjetit të ujësjellësit,që do me thënë me i ndruar gypat e vjetër me i vendosur gypat e ri.

Ne si komunë nuk kemi pasur mundësi me intervenuarë në këtë kompani.Sa i përket qështjes së mbeturinave i kemi trajtuar me seriozitet,unë si drejtor e kam hartuar një projekt për grumbullimin në fakt eliminimin e pikave të zeza në të gjitha fshatrat dhe qytetin e Malishevës.Ministria e ka nxjerrur një vendim me të cilën e kanë potencuar që qështja e mbeturinave urbane është barë ekskluzivishtë e komunës,ne jemi duke u munduar që me bërë këtë hap por sa i përket bashkëpunimit ne e kemi pasur më të mirë me K.R.M "EKO Regjionin".Unë e kam pregaditur një projekt me të cilën e kam dorzuar në zyrën e Kryetarit të komunës tonë e cila ka të bëjë me eliminimin e pikave të zeza,ne e kemi realizuar një aktivitet Taks Forca i cili ka dalur shumë mirë dhe angazhimi i saj ka ndikuar në vetëdijësimin e qytetarëve.

Komuna duhet me hartuar një projekt për vetëdijësimin e qytetarëve,në rradhë të parë duhet me u vetëdijësuar nxënësit,pastaj komiteti,shoqatat të gjithë faktorët që janë të rëndësishëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit,komuna nuk ka mundësi me mbrojtur ambientin pa një vetëdijesim të qytetarëve.

Unë jam duke e shtyer projektin te vetëdijesimi i qytetarëve,të cilën e kemi bërë edhe konkretisht,përmes platformave të ndryshme të komunikimit të vetëdijesohen qytetarët më shumë rreth pasojave të ndotjes së ambientit.Një rast konkret nëse jeni duke vozitur me makinë dhe fëmija hedh mbeturinat nga dritarja,pra fëmija e hedh në prezenc të prindit,nëse nuk i thuani asgjë kjo është në vetëdije shoqërore pra kjo është qështje e prindit dhe angazhimit familjar.Pra duhet me i pregaditur gjeneratat e reja për vetëdijësimi e ndotjes së ambientit.

Qështja tjetër është deponimi ilegal apo pikat e zeza siq jemi duke i quajtur ne,nëse dikush e hedh një qese me mbeturina,pastaj shkojnë edhe të tjerët hedhin mbeturina.Për hedhjen e mbeturinave të amvisësrisë janë kontinierat e posqame në zonat e ndryshme që janë vendosur kurse për mbeturinat inerte apo sanitarisë është deponia në Banjë.Nëse keni ndonjë pyetje ju lutem urdhëroni.

Hafir Rexha(anëtar i komisionit): Kryetari i komunës tonë z.Ekrem Kastrati vitin e kaluar muajin Prill e ka shpallur muajin e pastrimit.Unë ju përgëzoj për një angazhim të madh që e keni bërë,në kuadër të atij angazhimi është bërë edhe një lloj senzibizilimi në mes të qytetarëve dhe institucionit.Dëshiroj me i parashtruar dy pyetje drejtor.Sa keni pasur mundësi gjatë muajit Prill me i pastruar të gjitha pikat e mbeturinave inerte duke e pasur parasysh që komuna e Malishevës i ka 44 fshatra?A janë eliminuar të gjitha pikat e zeza?Në kuadër të atyre zonave që i keni pastruar a i keni shenjëzuar me njoftime?

Në mënyrë që mos të hudhen më mbeturinat.A është duke u respektuar ajo zonë që e ka pastruar komuna ?Nëse ne shkojmë sot a e gjemë sërisht në gjendjen të cilën e ka pastruar komuna?Sa e keni bashkëpunimin me drejtorin e inspektoriatit?Cili është relacioni në mes të drejtorisë së shërbimeve publike,inspektoriatit me qytetarët?A janë të informuar qytetarët për hedhjen e mbeturinave sepse ne kemi dy lloje të mbeturinave të amvisërisë dhe inerte,a janë të informuar qytetarët se në kontiniera që hudhen mbeturinat e amvisërisë nuk duhet me i hedhur mbeturinat inerte pasi që këto mbeturina duhet me i hedhur në zonën e cila merret me deponimin e mbeturinave inerte apo të sanitarisë.Faleminderit.

Izet Hoti(Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike): Taks Forca ka qenë një angazhim vullnetar me të cilën ne dhe qytetarët jemi ndarë të kënaqur me aktivitetin të cilin e kemi realizuarë,por ende duhet të senzibilozohen të angazhojnë kampanja vetëdijësuese.Ne kemi vendosur shenja me të cilën sinjalizohen qytetarët për ndalimin e hedhjes së mbeturinave,mirëpo përsëri kanë filluar me hedhur mbeturina mirëpo më tepër unë e konsideroj sferë e ndërgjegjes së qytetarëve,ndoshta nganjëherë pa ndonjë arsyeje edhe i bëjnë këto gjëra.

Sa i përket bashkëpunimit me drejtorin e inspektoriatit ne kemi bashkëpunuar,ata ju kanë shqiptuar vërejtje me shkrim në disa raste edhe i kanë gjobitur.Në disa zona janë vendosur kamera për monitorimin dhe evidentimin e hapsira me qëllim të mbrojtjes së ambientit.Komuna duhet me hartuar një program sidomos në sezonën e verës me pasur një aksion të fuqishëm për pastrimin e mbeturinave inerte.

Hafir Rexha(anëtar i komisionit): Si qëndronë gjendje në Banjë,a janë eliminuar deponitë e mbeturinave inerte?Unë kërkojë që këto deponi të eliminohen,me gjetur ndonjë formë apo edhe mënyrë vullnetare nga ndonjë kompani,apo ndonjë bashkëpunim me K.R.M "EKO Regjionin",me për ti elmininuar dhe pastaj me mbikqyrur atë hapsirë.

Izet Hoti(Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike): Unë e kam pregaditur një projekt konkret dhe e kam dorëzuar tek autoritet përkatëse,në kuadër të saj nënkuptonë eliminin e të gjithave mbeturinave për një vitë por kërkohet edhe kosto e konsiderueshme,por mendoj që Kryetari i komunës tonë ka me marrë seriozisht projektin tonë dhe ka me mbështetur.Pra duhet me u hartuar një projekt me baza vjetore që kur ka nevojë me interevenuarë.

Gjithashtu është edhe një projekt i Gizit Gjerman i cili është afërisht tridhjetë million euro i cili deri në vitin 2030 ka me u inplementuarë dhe investuarë,me të cilën kanë me promovuar qështjen e ambientit në nivel të vendit,shuma prej tridhjetë milion euro parashihet të përfshinë komunën e Prizrenit,Dragashit,Suharekës,Malishevës dhe Gjakovës aty është parashikuar që të bëhet një deponi e riciklimit të mbeturinave,me të cilën do të punësohen një numër i madh i punëtorëve.Ideja është që mbeturinat të trajtohen,riciklohen dhe mos të shkojnë të gjitha në deponi.Unë uroj që ky projekt të realizohet sa më shpejt.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala: Faleminderit i nderuar Drejtor,gjithashtu edhe unë e përgëzoj projektin e Gizit Gjerman sepse në momentin që fillojnë me i grumbulluar mbeturinat brenda komunës aty do të fillojë edhe reduktimi i kostos së shpenzimeve.Unë gjithashtu ju përgëzoj për projektin e kampanjën vetëdijësuese që e keni pasur.

Izet Hoti(Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike): Unë mendoj që problemi më i madh jo vetëm në komunën tonë por në tërë territorin e Republikës së Kosovës është recikilimi dhe trajtimi i mbeturinave,gjithashtu duhet me pasur më teprë kampanja konkrete vetëdijësuese duke filluar nga familja,shoqëria e kështu me rradhë.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala:Ju falenderoj drejtor për pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj në këtë takim.Unë ju bëjë apel të gjithë qytetarëve pa dallim që ta duan dhe mbrojnë vendin e tyre sepse është kënaqësi të gjeshë pastër por obligim ta mbash,sepse hedhja e mbeturinave jo vetëm që shkaktonë ndotjen e ambientit por paraqet rrezik tek kafshët veqanarishtë tek qenët endacak sepse ata shpesh duke i tërhequr qeset e mbeturinave i shpërndajnë më tepër,kjo pastaj përveq që e bënë ndotjen e ambientit e dëmton edhe imazhin e vendit.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës:Të ndryshme.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala:A ka dikush me marrë fjalën?Atëherë nëse nuk keni diqka për të diskutuar me kaq po e përfundojmë këtë mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i përfundoi punimet e mbledhjes rredh orës 10:30.

Malishevë Shtator,2026

Procesëmbajtsja

Fatlume Delija

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Fitim Shala